

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	02/09/		2026
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
02	400/01	-	37560



Republika e Kosovës/ Republic of Kosovo

Ndërmarrja Publike Lokale NPL "EKO-DRENASI" SH.A

Rr. "Besim Mala", Nr. 21 Glogoc

Në bazë të ligjit për ndermarrjet Publike Nr. 03/L-087 nenet 17 dhe 21 si dhe Ligjit 04/L-111 si dhe plotësim ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, neni 9 dhe 13 me te cilat nene, plotësohen dhe rifomulohen Nenet 17 dhe 21 të Ligjit bazik, si dhe **Vendimit 02/2026**, i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve (BPD) të NPL "EKO-DRENASI" SH.A., në mbledhjen e mbajtur më 27.08.2026 BPD shpallë këtë :

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e pozitës së punës

Kryeshef/e Ekzekutiv/e i Ndërmarrjes Publike Lokale "EKO-DRENASI" SH. A. në Glogoc

1. Të përgjithshme

Kandidatët për këtë pozitë, duhet të jenë persona me integritet të lartë moral dhe profesional, me aftësi udhëheqëse, vizion zhvillimor dhe përvojë të dëshmuar menaxheriale.

2. I raporton Bordit të Drejtorëve të NPL "EKO-DRENASI" SH. A

3. Orari i punës : 40 orë/javë

4. Mandati i Kryeshef/it,es Ekzekutiv/e

Kryeshef/it,es Ekzekutiv/e, përzgjidhet përmes një konkursi publik dhe emërohet nga Bordi i Drejtorëve në mandat prej 3 (tre) vite.

5. Kompensimi i Kryeshef/it,es Ekzekutiv/e

Kompensimi dhe përfitimet e Kryeshef/it,es Ekzekutiv/e fillimisht është përcaktuar nga BPD :

Paga mujore 750 Euro

Përshkrimi i punëve

Kryeshef/i, e Ekzekutiv/e, krahas punëve të parapara me dispozitat ligjore në fuqi, që rregullojnë Ndërmarrjet Publike:

- Bën planifikimin, organizimin dhe kontrollin e afarizmit të ndërmarrjes;
- Në bashkëpunim me përgjegjësit e njësive organizative, koordinon punët e ndërmarrjes me qëllim të implementimit sa më të drejtë të politikave zhvillimore të caktuara nga Bordi i Drejtoreve të Ndërmarrjes;
- Përcakton një strategji efektive për NPL "EKO-DRENASI" SH.A.;
- Bashkëpunon ngushtë me bordin e drejtorëve si dhe menaxhon kompaninë dhe para këtij organi raporton për menaxhimin e Ndërmarrjes;
- Bën sistemimin dhe organizimin e të punësuarve konform dispozitave pozitive dhe të politikave zhvillimore të Ndërmarrjes;
- Mbikëqyrë përgatitjen dhe implementimin e Planit të Biznesit me qëllim të përmirësimit të performancës së Ndërmarrjes;
- Udhëheqë dhe koordinon punët me udhëheqësit e departamenteve dhe stafit tjetër të ndërmarrjes;
- Të vendosë sisteme e procedura standarde për menaxhimin efektiv të NPL "EKO-DRENASI" SH. A.
- Përfaqëson ndërmarrjen në raport edhe me palët e treta;
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj, akte qeverisëse të ndërmarrjes dhe bën ekzekutimin e vendimeve dhe rekomandimeve të Bordit të Ndërmarrjes.

5. Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

1. Të ketë përgatitje profesionale në fushat ekonomike, juridike, menaxhim biznesi, të ndërlidhura me aktivitetet në të cilat vepron ndërmarrja;
2. Të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në menaxhim të lartë;
3. Të ketë shkathtësi organizative, drejtuese dhe aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit;
4. Shkathtësi të dëshmuara në punë me grupe dhe organizim të Ndërmarrjes apo të ngjashme;
5. Shkathtësi të mira në punën me kompjuter;
6. Preferohet njohja e gjuhës Angleze

6. Informatë për procedurën e konkurrimit

Kandidatët për Kryeshef/e Ekzekutiv/e, duhet t'i dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Diplomën e studimeve Universitare në fushat ekonomike, juridike, menaxhim biznesi, të ndërlidhura me aktivitetet në të cilat vepron ndërmarrja
2. CV-në - detajuar duke përfshirë datat e sakta të punësimit dhe detaje të përgjegjësive për çdo pozicion duke përfshirë nivelin e vendimmarrjes strategjike, numrin e punonjësve që mbikëqyrur, buxhetin dhe përgjegjësitë;
3. Dëshminë mbi përvojën e punës në përputhje me pikën 5 të këtij konkursi;
4. Certifikatën që nuk është nën hetime të lëshuar nga Gjykata kompetente (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
5. Kopjen e letërnjoftimit;
6. Deklarata nën betim: Aplikant/i,ja duhet të vendos datën dhe të nënshkruaj deklaratën nën betim. Kjo deklaratë mund të shkarkohet nga webfaqja e Komunës
7. Letër Motivimin

Kandidatët të cilët i nënshtrohen konkursit, duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues dhe e-mail adresën.

Të interesuarit, dokumentacionin me të gjitha dokumentet e parapara sipas pikës 5 dhe 6, të këtij konkursi, mund të i dorëzojnë në mënyrë fizike ose përmes Postës së Kosovës me këtë adresë ; objekti i **Komunës së Drenasit, Rr. "Fehmi e Xhevë Lladrovci" Nr. 2,**

13000 Drenas, Republika e Kosovës,

- Aplikacionet e dorëzuara me postë në mënyrë fizike , do të pranojnë konfirmim më së largu tre (3) ditë nga dita e dorëzimit të aplikimit, në të kundërtën do të konsiderohet se aplikimi sipas konkursit publik nuk është dorëzuar.
- Aplikacionet e dorëzuara në mënyrë fizike do të konsiderohen të vlefshme vetëm nëse arrijnë brenda 3 (tre)ditëve dhe në zarf të Postës së Kosovës figuron data e fundit e mbylljes së KONKURSIT PUBLIK.
- Në aplikacion, duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës, kurse dokumentet e bashkangjitura të aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen, dhe mund të kërkohen edhe dokumentet Origjinale me rastin e intervistimit.
- Aplikacionet e mangëta dhe ato jashtë afatit do të refuzohen.

Çdo përgënjeshttrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikim të menjëhershëm.

7. Procedura e rekrutimit

1. Aplikimet edhe në mënyrë elektronike përmes emailit: **Ekodrenasi@gmail.com** apo përmes **Arkives së Komunës** ose edhe përmes **Postës** do të pranohen nga **02.09.2026 deri me datën 16.09.2026 deri në ora 16:00**
2. Faza I e konkursit publik përfshinë vlerësimin administrativ të aplikimeve në përputhje me pikën 5 dhe 6 të këtij konkursi;
3. Aplikimet të cilat nuk janë në përputhje me pikën 5 dhe 6 të këtij konkursi, do të njoftohen dhe do të kenë të drejtë ankese në Bordin e Drejtorëve në afat prej tri (5) ditësh nga dërgimi i njoftimit;
4. Bordi i Drejtorëve do të shqyrtoj ankesat dhe kandidatët do të njoftohen mbi përgjigjet në ankesa;
5. Aplikimet të cilat janë në përputhje me pikën 5 dhe 6 të konkursit publik, do të njoftohen që kanë kaluar në Fazën II të konkursit publik;
6. Faza II e konkursit publik përmban vlerësimin sipas intervistës, ku secili kandidat do të vlerësohet deri në 100 pikë nga secili vlerësues;
7. Totali i pikëve të kandidatëve, do të pjesëtohet me numrin e vlerësuesve dhe kandidati i përshtatshëm për emërim konsiderohet në rast se ky i fundit arrin kalueshmërinë së paku 55 pikë nga totali prej 100 pikëve;
8. Kandidatët e intervistuar do të njoftohen mbi vlerësimin e tyre sipas intervistës;
9. Kandidat/i,ja i/e cil/i,a ka maksimumin e pikëve, do të mund të emërohet si Kryeshef/e Ekzekutiv/e ne NPL "EKO-Drenasi" SH. A.

NPL "EKO-DRENASI" SH. A. ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe inkurajon të gjitha femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve që plotësojnë kriteret sipas konkursit të aplikojnë.

Konkursi mbetet i hapur nga data 02.09.2026 deri me 16.09.2026 , në ora 16:00.

Kryesuesi i Bordit të Përkohshëm të
Drejtorëve





DEKLARATA NËN BETIM

Unë _____, me nr.personal: _____, i lindur më (data e lindjes),
në _____ (vendi i lindjes) _____, aplikoj në N.P.L "EKO-DRENASI" SH.A , në
Drenas për poziten: **Kryeshef/e Ekzekutiv Ndërmarrjen Publike Lokale**, me ç' rast nën përgjegjësi të
plotë deklaroj se të gjitha informatat e dhëna në aplikacionin janë të vërteta dhe se nuk ka asnjë
pengesë ligjore në lidhje me aplikimin tim në këtë pozitë.

Deklaroj se unë i plotësoj të gjitha kushtet profesionale dhe personale të parapara me ligjin për
Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, konkretisht neni 17 pika 17.1, (ii) i plotësoj kriteret e pavarësisë sipas
nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) dhe nenin 21, dhe plotësim ndryshimet përkatëse me Ligjet
nr.04/L-111, ndryshim plotësimin e Ligjit për NP Ligji nr. 05/L -009, Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të
interesit në ushtrimin e funksionit publik nr. 06/L-011 si dhe legjislacionit tjetër relevant .

Çdo përgënjeshttrim material – qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim material nga
informatat e dhëna në deklaratën e sipërcekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm dhe
nëse është e aplikueshme, largimin e personit.

Emri, mbiemri

Nënshkrimi

Vendi:

Datë:

VËREJTJE: Kjo Deklaratë dhe ky Betim nuk konstituon asnjë lloj marrëdhënie të çfarëdollojshme
ndërmjet kandidatit dhe N.P.L "EKO-DRENASI" SH.A.: dhe si e tillë trajtohet si e veçantë dhe pavarur
në raport me çfarëdo kontesti apo kundërthënie.



APLIKACION PUNËSIMI

Pozita për të cilën aplikoni:	
Numri i references	

1.TË DHËNAT PERSONALE

Emri:	Mbiemri:	Nr. personal:
Data e lindjes:	Vendi i lindjes:	Shteti:
Adresa:	Kodi postar:	Qyteti:
Telefoni:	Tel. Mobil:	E-mail:
Nacionaliteti (opsionale):	Statusi martesor:	Nënshtetësia:
Të afërm të punësuar në N.P.L "EKO-DRENASI" SH.A , në Drenas	☐ Po ☐ Jo	Nëse po (Emri dhe pozita):

2.EDUKIMI/ARSIMIMI

Emri i institucionit dhe vendi:	Data(M/V):	Drejtimi:	Kualifikimi:	Diplomuar:
	Prej:_____Deri:_____			☐ Po ☐ Jo
	Prej:_____Deri:_____			☐ Po ☐ Jo
	Prej:_____Deri:_____			☐ Po ☐ Jo

3.NJOHJA E GJUHËVE

Gjuha amtare: _____ (Shkruani nivelin e njohjes së gjuhëve sipas shkallës (5 Shkëlqyeshem, 4 sh.mirë, 3 Mirë, 2 Dobët)

	Angleze						
E folur							
E shkruar							

4. SHKATHTËSITË NË KOMPJUTER

Zgjedhni nivelin e shkathtësisë suaj në përdorimin e programeve kompjuterike sipas mundësive të dhëna më poshtë:

Programet	Dobët	Mirë	Shumë mire
Microsoft WORD			
Microsoft EXCEL			
Microsoft OUTLOOK			

Tjetër program (më poshtë mund ta cekni nëse keni shkathtësi për ndonjë program tjetër)

N.P.L "EKO-DRENASI" SH.A , në Drenas

5. PËRVOJA PROFESIONALE MENAXHERIALE

Përdorni këtë pjesë që t'i paraqisni vendet e mëparshme të punës dhe përshkrimin e detyrave të punës. (Nëse kjo hapësirë nuk ju mjafton që t'i cekni të gjitha përvojat tuaja profesionale, atëherë mund të përdorni letër shtesë dhe t'ia bashkangjisni aplikacionit).

Emri i punëdhënësit:	Adresa:
Punësuar prej: (M/V) _____ deri: (M/V) _____	Nr. kontaktues:

Pozita juaj:
Përshkrimi i vendit të punës:

Emri i punëdhënësit:	Adresa:
Punësuar prej: (M/V) _____ deri: (M/V) _____	Nr. kontaktues:

Pozita juaj:

Përshkrimi i vendit të punës:

Emri i punëdhënësit:	Adresa:
Punësuar prej: (M/V) _____ deri: (M/V) _____	Nr. kontaktues:

Pozita juaj:

Përshkrimi i vendit të punës:

N.P.L "EKO-DRENASI"SH.A , në Drenas

6. Përshkruani me pak fjalë nga pikëpamja juaj, eksperiencia dhe të dhënat e më hershme se si e konsideroni veten tuaj të përshtatshëm për pozitën në të cilën aplikoni.

--

Data:

Nënshkrimi: _____